

# BULETINI 3 - MUJOR

Janar - Mars  
2026



Vizitë e delegacinit  
kroat në AZHBR



Marrëveshje bashkëpunimi  
AZHBR - ASIG

## MIRATOHET SKEMA KOMBËTARE NË BUJQËSI 2026

# MIRATOHET

## SKEMA KOMBËTARE NË BUJQËSI

# 2026

### # MASAT MBËSHTETËSE

Qeveria shqiptare ka miratuar Skemën Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi për vitin 2026, një hap i rëndësishëm drejt forcimit të sektorit rural dhe rritjes së prodhimit vendas.

Përmes kësaj skeme synohet mbështetja direkte e fermerëve, nxitja e investimeve dhe garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Këtë vit, skema parashikon një mbështetje më gjithëpërfshirëse përmes masave të reja financuese dhe disa risive të rëndësishme. Procedurat dhe afatet e aplikimit do të bëhen të ditura përmes publikimit të udhëzimit për aplikim.

Skema Kombëtare është një mbështetje konkrete për fuqizimin e bujqësisë dhe rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare në treg.



## VIZITË E DELEGACIONIT KROAT, FOKUS BASHKËPUNIMI DHE SHKËMBIMI I PËRVOJAVE

Në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm institucional, Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural mirëpriti në një vizitë zyrtare delegacionin kroat, të kryesuar nga Sekretari i Shtetit për Bujqësinë dhe Çështjet Ndërkombëtare, si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Pagesave. Vizita kishte si qëllim shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e bujqësisë, në funksion të përmbushjes së standardeve dhe kërkesave të Bashkimit Evropian.

Gjatë takimit, palët diskutuan mbi një sërë çështjesh me rëndësi për zhvillimin institucional dhe administrimin e mbështetjes në sektorin bujqësor. Në fokus të diskutimeve ishin ndërtimi dhe funksionalizimi i sistemeve IACS dhe LPIS, regjistri i fermave, menaxhimi financiar dhe kontrolli, si dhe procesi i akreditimit të agjencive të pagesave. Vizita shërbeu për të identifikuar fusha konkrete bashkëpunimi dhe për të forcuar mbështetjen reciproke mes dy vendeve.

## AZHBR PJESË E MATCHMAKER ALBANIA – EDICIONI II



Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural mori pjesë në MatchMaker Albania, Edicioni II, një platformë e rëndësishme që bashkon aktorë të ndryshëm për të diskutuar mbi inovacionin, teknologjinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Në këtë aktivitet, Drejtoresha e AZHBR foli mbi të ardhmen e bujqësisë dhe rolin gjithnjë në rritje të teknologjisë në transformimin e sektorit bujqësor, duke theksuar rëndësinë e digjitalizimit, sistemeve inteligjente dhe mbështetjes institucionale për një bujqësi më moderne, më efikase dhe konkurruese.

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI AZHBR - ASIG



Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për ndërtimin dhe zhvillimin e Sistemit të Identifikimit të Parcelave të Tokës.

Marrëveshja synon forcimin e bashkëpunimit institucional dhe garantimin e një shkëmbimi të strukturuar dhe efektiv të të dhënave gjeohapësinore, përfshirë ortofoto, imazhe satelitore dhe shtresa referuese, në përputhje me standardet kombëtare dhe kërkesat e Politikës së Përbashkët Bujqësore të Bashkimit Evropian.



Kjo marrëveshje përbën një hap konkret drejt ndërtimit të një sistemi të integruar, të besueshëm dhe të harmonizuar me standardet evropiane, duke forcuar transparencën, saktësinë dhe efikasitetin në administrimin e skemave të mbështetjes në sektorin bujqësor.

## ZHVILLIMI RURAL DHE BUJQËSOR NË FOKUS TË PANELIT PËR KORRIDORIN VIII

Në panelin e “Korridori VIII – katalizator i ndërlidhjes së qëndrueshme dhe rritjes së gjelbër”, u diskutua dhe për dy pika thelbësore që lidhen drejt për drejt me zhvillimin rural dhe bujqësor:

- Projektet rurale dhe bujqësore të lidhura me Korridorin VIII janë një motor real për zhvillimin territorial dhe ekonomik.
- Financimi IPARD dhe instrumentet e tjera mbeten kyçe për të garantuar një zhvillim rural të qëndrueshëm, në linjë me objektivat e Green Deal.

Ndërlidhje, qëndrueshmëri dhe rritje e gjelbër, investim për të ardhmen e zonave rurale.





## PJESËMARRJE NË GFFA 2026 NË BERLIN

Edicioni i 18-të i Forumit Global të Ushqimit dhe Agrikulturës (GFFA), i zhvilluar në Berlin me temën “Uji. Të korrat. E ardhmja jonë.”, mbledhi ministra të bujqësisë dhe përfaqësues të lartë nga mbarë bota.

Në forum mori pjesë edhe delegacioni shqiptar, i cili zhvilloi takime dhe diskutime mbi bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe afrimin me standardet europiane.

## WORKSHOP 2-DITOR MBI ZBATIMIN E SISTEMIT LPIS

AZHBR mori pjesë në workshop-in e organizuar nga UNOPS, i cili mbështet ngritjen e Sistemit të Identifikimit të Parcelave Bujqësore (LPIS), një komponent kyç i Sistemit të Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (IACS).

Workshop-i u organizua pas përfundimit të fazës së parë të projektit pilot LPIS në Qarkun e Beratit dhe i paraprin fazës së dytë të zbatimit, me fokus përfshirjen e fermerëve për konfirmimin dhe pasurimin e të dhënave fillestare, të përfuara nga interpretimi i imazherisë satelitore.

Gjatë aktivitetit u prezantuan përvoja nga vendet e BE-së, ecuria e projektit pilot në Shqipëri, si dhe roli i LPIS në përmirësimin e administrimit të skemave të mbështetjes në bujqësi dhe procesin e integritetit evropian.

Projekti EU4Property Rights financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga UNOPS, në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.



# 65,435

## FERMERË PËRFITUES

## SKEMA KOMBËTARE 2025

### SKEMA KOMBËTARE 2025

### 65,435 FERMERË PËRFITUES

Skema Kombëtare e Subvencioneve 2025 mbështeti 65,435 fermerë në të gjithë vendin, me një fond total prej 5.152 miliardë lekësh.

Përmes tetë masave mbështetëse, fermerët u subvencionuan për blegtorinë, bletarinë, prodhimin në serra, kultivimin e bimëve mjekësore - aromatike, fermat organike, certifikimin GlobalG.A.P., si edhe për naftën në punimet e mekanizuara në bujqësi.

Kjo mbështetje kontribuon drejtpërdrejt në uljen e kostove, rritjen e konkurrueshmërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor në të gjithë vendin.

## TAKIME KONSULTUESE - SKEMA KOMBËTARE NË BUJQËSI 2026



Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, zhvilluan një tur dëgjësash publike në të gjithë vendin për përcaktimin e masave mbështetëse të Skemës Kombëtare 2026.



Në kuadër të këtij procesi u organizuan 23 takime në 12 qarqe, me pjesëmarrjen e fermerëve, grumbulluesve, përfaqësuesve të agrobiznesit dhe aktorëve të tjerë të zinxhirit të vlerës. Gjatë këtyre takimeve u evidentuan problematikat në terren, u adresuan shqetësimet konkrete dhe u mblodhën propozime për përmirësimin e skemës.



Skema Kombëtare 2026 do të nisë me një buxhet prej 5,2 miliardë lekësh, ose 16% më shumë se një vit më parë. Krahas mbështetjes direkte, ajo do të përfshijë edhe instrumente financiare lehtësuese, si kredia e butë me garanci sovraane, si dhe kompensimin 10% të autofaturave tatimore, që do të dorëzohen dy herë në vit.